



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/20/22

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Kryetarja e Gjykatës, Albina Shabani Rama, ka inicuar procedurë disiplinore sipas detyrës zyrtare ndaj gjyqtarit L.SH për shkak të dyshimit të arsyeshëm për shkelje disiplinore nga neni 5 par.2 pika 2.9 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe neni 7 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 20.05.2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

Hudhet rasti i inicuar sipas detyrës zyrtare ndaj gjyqtarit L.SH i datës 20.04.2022, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Personi NN me datë 29.03.2022 përmes email-it ka dërguar një njoftim te Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe tek Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me pretendime se gjyqtari i Gjykatës Themelore në Prishtinë L.SH ka kryer shkelje disiplinore.

Parashtruesi anonim i ankesës ka pretenduar se, me datën 24.03.2022 e ka parë në Gjykatën Themelore në Gjakovë, Dega në Malishevë, gjyqtarin e Gjykatës Themelore të Prishtinës L.SH i cili ka qëndruar tërë ditën në Gjykatën Themelore në Malishevë i cili ka bërë trysni dhe ushtrim ndikimi ndaj gjyqtarit L.P për një rast i cili ka kërkuar se me çdo kusht të lirohet një i akuzuar të cilin thoshte se e kishte burrë të motrës. Ka theksuar se, kjo shihet si një hakmarrje ndaj të dëmtuarit S.H. Ku S.H është i lënduar me lopatë në kokë dhe ka lëndim të rëndë dhe ka mundur të jetë vdekje-prurëse. Tutje parashtruesi anonim i ankesës ka theksuar se, personi i akuzuar ishte B.H.K nga Komuna e Malishevës nga fshati Damanek, të cilit iu ka caktuar paraburgimi për 1 muaj për veprën penale lëndim i rënd trupor. Personi NN, gjithashtu ka deklaruar se gjyqtari SH., ka bërë trysni që me çdo kusht të lirohet i akuzuari ose të arrestohet edhe i dëmtuari S.H. Dhe ashtu ndodhi të dytë përfunduan në paraburgim. Ka shtuar se, i njëjti gjyqtar ka pasur edhe disa raste në Malishevë të B.K të cilat i ka mbyllur në favor të tij edhe pse ishte fajtor për çdo vepër. Ka theksuar se është punëtor i Gjykatës në M., por dëshiron të mbetet anonim për shkaqe të sigurisë.

Me datë 29.03.2022 Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate përmes email-it dërguar parashtruesit anonim ka kërkuar informata plotësuese dhe identitetin e tij si dhe adresën e tij, duke e njoftuar parashtruesin se sipas nenit 7 par. 2 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të

Gjyqtarëve, nuk lejohen ankesat anonime për gjyqtar. Me datë 05.04.2022 është njoftuar Këshilli Gjyqësor për pranimin e ankesës disiplinore anonime.

Pasi parashtruesi nuk iu është përgjigjur Autoritetit Kompetent brenda afatit 8 ditor nga dita e pranimi të kërkesës për dhënie të informatave plotësuese, Autoriteti i kësaj gjykate me datë 12.04.2022 ka hudhur si të palejueshme ankesën anonime, me nr AD/GJTHPR/16/22.

Ndaj të njëjtit rast, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 20.04.2022 ka inicuar sipas detyrës zyrtare procedurë disiplinore ndaj gjyqtarit L.SH për trajtimin e pretendimeve për të vlerësuar se a ka baze për inicim të procedurës disiplinore sipas detyrës zyrtare ndaj gjyqtarit L.SH .

Me datë 22.04.2022 nga Nd. Administratori i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë është kërkuar të sigurohen pamjet (inçizimet) e objektit të gjykatës të datës 24.03.2022.

Me datë 22.04.2022 është pranuar njoftimi nga Nd. Administratori i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë, se kjo gjykatë posedon dy driver-a për incizim brenda dhe jashtë objektit, driver-i që ka qenë i ngarkuar me më shumë kamera ka regjistruar deri me datë 28.03.2022, që do të thotë se nga data 28.03.2022 nuk kanë mundur të sigurohen xhirimet, ndërsa nga driver-i i dytë janë nxjerr të gjitha pamjet (xhirimet) e datës 24.03.2022 të cilat janë bartur në USB dhe janë në dispozicion për rastin.

Me datë 26.04.2022, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë ka pranuar USB me xhirimet (pamjet) e jashtme të objektit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë, të datës 24.03.2022.

Gjithashtu me datë 26.04.2022 është kërkuar nga Nd. Administratori i Degës së Malishevës shkresat e lëndës 2022:056351, me të njëjtën datë janë siguruar shkresat e lëndës 2022:056351.

Me datë 05.05.2022 është kërkuar nga gjyqtari L.SH përgjigje/deklaratë se a ka qenë me datë 24.03.2022 në Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë.

Gjyqtari L.SH iu është përgjigjur Autoritetit Kompetent të kësaj gjykate me tri deklarata, dy deklarata të datës 05.05.2022 dhe tjera e datës 20.05.2022.

Në deklaratat e tij gjyqtari L.SH ka deklaruar se, me dt.24.03.2022, ka qenë në Gjykatën Themelore në Gjakovë- Dega në Malishevë, për arsyen se gjyqtarit N.Q gjyqtar në atë degë dhe shok i tij ditë më parë i ka vdekur djali i axhës të cilin e ka njohur edhe personalisht dhe nuk ka pasur mundësi që ta shoh dhe ta ngushëlloj, dhe ky ka qenë qëllimi pse ka shkuar në atë Gjykatë. Tutje gjyqtari ka theksuar se, gjithashtu shokut A.G (Kryetar i Odës së O.P) të cilin e ka shok që nga shkolla e mesme dhe fakulteti, ato ditë i ka vdekur djali i vëllait 4 vjeç, dhe shoqëria e tyre përbashkët kanë organizuar që me datën 24.03.2022, të shkojnë për ngushëllime për vdekjen e djalit të vëllait. Ka shtuar se, atë ditë nuk ka pasur seancë të caktuar dhe ka shfrytëzuar kohën për të shkuar në Malishevë që ta shoh gjyqtarin N. ta ngushëlloj dhe së bashku me shok tjerë të shkojnë ta ngushëllojnë A.G. Ka theksuar se, atë ditë e ka njoftuar edhe gjyqtarin V.K, përgjegjës i Departamentit Special. Tutje në deklaratën e tij gjyqtari ka theksuar se, atë ditë pas orës 10 është nisur me veturë nga Pallati i Drejtësisë në drejtim të Gjykatës në Malishevë dhe ashtu rreth orës 11 ka hyrë në Gjykatën në Malishevë, pasi është njoftuar se gjyqtari N. gjendet në seancë, fillimisht e ka pritur tek zyra e referenteve pastaj te zyra e ekzekutimeve të gjykatës, pastaj ka shkuar në zyrën e mbikëqyrësit të degës me qëllim që ta përshëndes, por nuk ishte në zyre, pastaj është takuar me zyrtaren ligjore të gjyqtarit L.P, e cila e ka njoftuar se gjyqtari L., është në sallë

bashkë me prokuroren M.S pastaj ka shkuar në sallë dhe është përshëndet me Prokuroren M.S dhe me Gjyqtarin L.P, dhe takimi me këta të dytë ka zgjat jo më shumë se 2-3 min dhe është përshëndet me ta dhe ka dal në korridor të gjykatës është takuar me gjyqtarin N. dhe janë dal bashkë prej gjykate diku rreth orës 12:00, dhe ka drekuar me të. Ndërsa rreth orës 14 është takuar me shokët të tjerë dhe kanë shkuar në fshatin Peqan për ngushëllime. Ka shtuar se, lidhur me pretendimet e personit NN se ai si gjyqtar ka shkuar me qëllim që të ndikoj tek gjyqtari L.P ky pretendim nuk qëndron pasi arsyen pse ka shkuar në atë gjykatë e ka cekur, ka theksuar se ka qenë 5 vite gjyqtar në atë gjykatë dhe e njeh të gjithë stafin, ndërsa gjyqtarin L.P e ka pasur mbikëqyrës për 5 vite radhas dhe përveç që e ka respektuar si mbikëqyrës ka pasur vetëm raporte kolegiale. Ka shtuar se, lidhur me pretendimin se personin me emrin B.H.K e ka burrë të motrës ky pretendim nuk qëndron, pasi që me të njëjtin nuk e ka asnjë lidhje as farefisnore e as miqësore, përveç që janë të së njëjtës komunë. Në deklaratën e tij, gjyqtari L.SH ka theksuar se, B.K gjatë vitit 2017 e ka gjykuar lidhur me një aktakuzë për mashtrim dhe ndaj të njëjtit është marr aktgjykim lirues i cili aktgjykim me ankesë ka shkuar në Gjykatën e Apelit dhe po e njëjta gjykatë e ka vërtetuar këtë aktgjykim. Tutje, gjyqtari ka deklaruar se, për dijeninë e tij asnjë raste tjetër nuk e ka vendosur ku i akuzuar ka qenë B.K, sepse nuk ka pasur rast të tij në punë. Ka shtuar se, lidhur me pretendimin se ai ka qenë në dijeni për seancë e asaj dite kjo nuk qëndron pasi nuk ka qenë në dijeni se ai person ka seancë atë ditë, sepse ai si gjyqtar ka shkuar në atë gjykatë për arsyet që tashmë i ka cekur.

Me datë 12.05.2022 Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë, L.P.

Me datë 13.05.2022 gjyqtari L.P ka theksuar se, me datë 24.05.2022 ka qenë në sallë te gjykimeve pasi tërë ditën ka pasur seanca gjyqësore, në pauzë në mes te seancave në sallë ka hyrë gjyqtari L.SH ku është përshëndetur me të, sekretaren juridike B.K dhe Prokuroren e shtetit M.S dhe vetëm e kanë pyetur për shëndetin pasi kanë dëgjuar se ka pasur një sulm në zemër dhe asgjë me tepër dhe krejt qëndrimi i tij ka qenë rreth 2 min dhe ka dal nga salla. Ka theksuar se, lidhur me lëndën PP.nr.27/22 me përgjegjësi deklaroi se nuk ka pyetur e as që është biseduar për këtë lëndë dhe për këtë janë dëshmitare sekretarja juridike dhe prokurorja e shtetit. Ka shtuar se, nuk kanë qenë në dijeni për këtë lëndë kur ka qenë gjyqtari L.SH në objekt, ku lënda është dorëzuar nga prokuroria në gjykatë në mbrëmje me datën 24.03.2022 në ora 16 e 55 min.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, shiqimit të kamerave të objektit në degën e Gjykatës në M., deklaramit të gjyqtarit L.SH , dhe gjyqtarit L.P, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit L.SH .

Autoriteti i kësaj Gjykate bazuar në faktet e çështjes ka gjetur se, nuk ka baza të arsyeshme për inicimin e hetimeve për shkelje disiplinore ndaj gjyqtarit L.SH lidhur me lëndën P.nr.27/22 (2022:056351) të cilat janë inicuar sipas detyrës zyrtare.

Nga shkresat e lëndës P.nr.27/22 rezulton se, Prokuroria Themelore në Gjakovë me datë 24.03.2022 ka nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve ndaj të pandehurit B.K për shkak të veprës penale “Lëndim i rëndë trupor” nga neni 186 par.3 nën par. 3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe ndaj të pandehurit S.H për shkak të veprës penale “Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së. Gjithashtu nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 24.03.2022, Prokuroria Themelore në Gjakovë ka parashtruar kërkesë për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurve B.K dhe S.H, ndërsa seanca dëgjimore lidhur me caktimin e paraburgimit është mbajtur me datë 25.03.2022. Nga procesverbali i seancës dëgjimore për caktimin e paraburgimit

konstatohen se prezent kanë qenë: gjyqtari i procedurës paraprake L.P, sekretarja juridike B.K, prokurori i shtetit K.M, të pandehurit B.K dhe S.H me mbrojtësit e tyre. Nga aktvendimi PP.nr.27/22 (2022:056351) i datës 25.03.2022 konstatohet se Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në M., ka caktuar paraburgimin ndaj të pandehurve për veprat penale, të cekura si në kërkesën e Prokurorit të shtetit për caktimin e paraburgimit. Nga aktvendimi P.nr.59/22 (2022:056351) i datës 19.04.2022 rezulton se të pandehurve B.K dhe S.H iu është ndërprerë masa e paraburgimit, për faktin se pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të pandehurit e kanë pranuar fajësinë.

Nga shikimi i kamerave të sigurisë në objektin e Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në M., nuk mund të vërtetohet asnjë pretendim i palës pasi që nga gjykata e M., janë siguruar vetëm pamjet e incizimeve të kamerave të objektit përreth dhe jo edhe të hyrje kryesore të palëve por vetëm të parkingjeve dhe shkalleve ndihmese e që në fakt nuk tregojnë asgjë.

Nga deklaratat e gjyqtareve L.SH dhe L.P rezulton se është e vërtet se ata janë takuar me datë 24.03.2022 në sallën e gjykimit, në kohën kur gjyqtari L.P ishte në pauzë në mes të seancave, e ku prezent kanë qenë edhe personat tjerë, si prokurorja e shtetit dhe sekretarja juridike, për më tepër nga deklarata e gjyqtarit L.P rezulton se kërkesa e prokurorisë për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurve ka ardhur me datën 24.03.2022 pas orarit të punës, konkretisht në ora 16:55, pra në kohën kur gjyqtari L.SH nuk ka qenë në Gjykatën Themelore në Gjakovë – Dega në M.,.

Po ashtu në bazë të provave të mbledhura, autoriteti kompetent nuk ka mundur të vërtetojë se i pandehuri B.K është familjar i gjyqtarit L.SH, e po ashtu me asnjë provë nuk vërtetohet se gjyqtari L.SH ka pas ndonjë qëllim për çështjen penale në fjalë.

Nën dritën e rrethanave të rastit, duke i pasur parasysh veprimet e ndërmarra nga Autoriteti Kompetent dhe provat e grumbulluara në fazën hetimeve preliminare të inicuar sipas detyrës zyrtare, rezultoi se në veprimet e gjyqtarit L.SH nuk ka shkelje disiplinore të parashikuar me nenin 5 par.2 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me procedurën e inicuar sipas detyrës zyrtare, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 2, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/20/22, me datë 20.05.2022

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë